



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË

Sarandë, më ____ . ____ . 2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Karburant (Aparati, Bordi, PMNZSH)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Karburant diesel -09134100-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

6 583 333 (gjashte milion e peseqind e tetedhjetë etre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë paTVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Sarandë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1, shkronja “a”, dhe pika 2, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur/fondit limit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe në nenin 43, pikat 1, 2, 3 dhe 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë neëkohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit tatimor dhe kontabël në fuqi, konkretisht Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 26, datë 08.09.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje legjislacionin tatimor në fuqi për deklarimin vjetor të të ardhurave dhe dorëzimin e dokumentacionit financiar, konkretisht Ligjin nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 26, datë 08.09.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate (*apo shumatores së fondit limitit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohe për më shumë se një lot*).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, **dhe të deklaruara në organet tatimore** ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. ...

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe në nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limitit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave që janë objekt prokurimi. kontratën pa vonesa dhe pengesa që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme/ duhet të jetë i pajisur me leje tregtimi ose liçencë per tregtim karburantesh kodi VIII.I.A (Tregëtim me shumicë: Gazoil kategoria III/A)/ ose operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë liçencat/lejet përkatëse për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëng-shëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante, në përputhje me Ligjin Nr. 8450, date 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe në nenin 40, pika 5, shkronja “a”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe

Në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Leje mjedisore të tipit B, lëshuar sipas legjislacionit në fuqi dhe Vërtetim teknik dhe duhet të paraqes Police Sigurimi lëshuar nga shoqërit e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për depozitat e tregëtimit me shumicë që vërteton kapacitetet depozituese mbi rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe në nenin 40, pika 5, shkronja “a”, pika 7, shkronja “c”, dhe pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, të ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analizë për produktet e kërkuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) ose nga një organ/subjekt kompetent i certifikuar/autorizuar/akredituar, i cili duhet të jetë në përputhje me standartet në fuqi dhe ku të jenë qartësisht të përcaktuara të gjitha të dhënat e këtij artikulli, me qëllim krahasimin e tij me specifikimet teknike. Fletë analiza të jetë e lëshuar jo më herët se tre muaj nga data e hapjes së ofertave.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe në nenin 40, pika 6, shkronja “c”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI), që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë përgjatë vitit të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.3.6 Subjekti ofertues duhet të ketë minimalisht 1 (një) stacion të tregtimit me pakicë të karburantit brenda teritorit të Bashkisë Sarandë, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale qeraje ose akt pronësie, ose të jenë të pasqyruara në ekstratin tregtar të operatorit ekonomik pjesëmarrës ;

- a. Stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve detyrimisht duhet të jenë të pajisur me leje tregtimi ose licencë për tregtim karburantesh kodi VIII.I.A (Tregëtim me shumicë: Gazoil kategoria III/A) ose leje tregëtimi në përputhje me dhe në zbatim të Ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre.” I ndryshuar dhe VKM Nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe në nenin 40, pika 5, shkronja “a”, pika 7, shkronja “c”, dhe pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe

Në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, të ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar.

Duke qenë se Bashkia Sarandë ka një numër të konsiderueshem mjetesesh, do të ishte e nevojshme që subjekti ofertues të ketë minimalisht 1 stacion të tregtimit me pakicë të karburantit. Para vendosjes së këtij kriteri NJHD ka bërë hetim të tregut dhe ka konstatuar se ka disa operatorë që kanë 1 (një) stacion të tregtimit me pakicë të karburantit brenda teritorit të Bashkisë Sarandë.

- 2.3.7** Për arsye të nevojës së punës të mjeteve të Bordit të Kullimit dhe mjeteve të sektorit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH), operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi të vet ose me qira të paktën 1 (një) mjet autobot. Për të provuar disponimin e tyre (në pronësi) shoqëria duhet të dorëzojë lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transportin e mallrave të rezikshëm, Pasaportën e autobotit, certifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe certifikatën e verifikimit të kontabilitetit të lëshuar nga DPM. Nëse mjetet janë me qira, të paraqitet përveç dokumentacionit të mësipërm edhe kontrata noteriale e qirasë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe në nenin 40, pika 5, shkronja “ç”, si dhe pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Për arsye të nevojës së punës të mjeteve të Bordit të Kullimit dhe mjeteve të sektorit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH), që e kanë të pamundur ardhjen në pikat e shpërndarjes së karburantit me pakicë, duke qenë mjete tepër të rënda dhe me zinxhire. Gjithashtu sqarohet se furnizimi i këtyre mjeteve bëhet në sasi të mëdha depozitimi dhe me kupon tatimor bashkëngjitur.

2.3.8 Operatori Ekonomik ofertues duhet te kete certifikatat ISO si me poshte:

- Çertifikatë ISO 9001:2015 Për Sistemin e menaxhimit të Cilësisë, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme), e cila duhet të jetë e akredituara nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-seNr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma çertifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

ISO 9001:2015

ISO 9001 është standardi më popullor i publikuar në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë të cilat mund të implementohen dhe certifikohen nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensionit të saj apo fushës së aktivitetit.

Kërkesat e ISO 9001:2015 i referohen aspekteve të ndryshme siç janë: implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankësive të marra dhe vlerësimi i furnitorëve.

Certifikimi ISO 9001 përfaqëson një konfirmim të faktit që shoqëria respekton një seri kërkesash të pranueshme në nivel ndërkombëtar. Mbajtja e certifikimit sjell disa përparësi për shoqërinë siç janë: akses tek procedurat e tenderave publike, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur aponjë imazh më të mirë në sytë e klientëve.

2.3.9 Subjekti ofertues duhet të paraqesë dhe deklaratat si më poshtë:

- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë në shërbim 24 orë, me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor, me tollon ose bot, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se mer përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Subjekti duhet të deklarojë se mer përsipër që të konvertojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në karten elektronike të personalizuar me targën e mjetit me tollon ose në lëng me bot. Deri në përfundimin e plotë të kontratës sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Karta elektronike duhet të jetë pa afat skadence deri në përfundimin e plotë të kontratës.

- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nëpërmjet kartave elektronike tëpersonalizuara sipas adresave të Autoritetit Kontraktor.

- Bazuar në VKM nr.561 date 29. 07.2016 “ Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve në njësinë e qeverisjes së përgjithshme” Operatores ekonomik pjesmerës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (ëebpage),ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit

dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.

- Faqja e menaxhimit të karburanteve (ëebpage) duhet të ofroje shërbimin e ngarkimit tësasisë së karburantit nga Operatori Ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet autoriteti kontraktor.

- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara me sipër në mënyrë elektronike nëpërmjet faqes së menaxhimit të karburanteve (ëebpage) që ofron çdo operator ekonomik pjesmarrës përben shkak për skualifikim.

Argumentimi: Në bazë, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të ProkurimitPublik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që disponibilitet te nevojshme për realizimin me sukses të kontratës sipas kerkesave te AK.

Bazuar në VKM nr.561 date 29. 07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve në njësinë e qeverisjes së përgjithshme” Operatores ekonomik pjesmarës duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi të karburanteve (webpage),ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT: